



RENOFIX DICHTUNGSCHEME

Material Mineral
Hidroizolues

Detyrimisht të i përmbaheni udhëzimit teknik!

HAPËSIRAT E PËRDORIMIT:

Përdoret si material për hidroizolim nëpër banjo, balkone, pishina; në objekte të vjetëra si dhe objekte të reja në të gjitha sipërfaqet me lagështisi (bodrume, dhe ambiente me lagështi).

PËRMBAJTJA:

- Çimento
- Shtesa që i përmirësojnë veçoritë e përpunimit
- Përbërës organikë <5%

VEÇORITË:

- Ujërezistues
- Qëndrueshmëri permanente ndaj lagështisë
- Mundësi e madhe e ngarkesës mekanike
- Rezistues ndaj ujit nën shtypje deri 1.5 bar

PËRGATITJA E BAZËS:


Bazamenti duhet të jetë i thatë, i pastruar nga pluhuri, vajrat dhe mbeturinat. Materiali i vjetër të largohet nga bazamenti; fugat dhe çarjet paraprakisht të mbushen. .

PËRGATITJA E LLAÇIT:

Një thes nga materiali, nëse punohet me rrafshues metali (gletkele) janë të nevojshme 4-5 litra ujë të pastër, me rul 6-6.5 litra ujë të pastër dhe përzihet me mikser për afro 2-3 minuta që materiali të jetë pa toptha. Pas 10 minutave përzihet sërish.

PËRPUNIMI DHE PËRDORIMI:

Materiali i përzier mbi bazamentin vendoset me rrafshues metali (gletkele), furçë apo rul. Materiali vendoset në trashësi nga 1-2 mm. Pas 12 orëve vendoset sërish me trashësi të njëjtë. Në trashësitë më të mëdha, vendoset në disa shtresa. Materiali i freskët vendoset brenda 2 orëve. Nëse pritet që sipërfaqja të jetë më shumë e ngarkuar me ujë, atëherë preferohet vendosja e disa shtresave. Të mos përdoret i ekspozuar direkt në diell. **Nuk lejohet përdorimi në temperaturë nën +5°C.** Nuk lejohet përzierja me materiale tjera.



VËRREJTJE:

Përmban çimento. Irriton sytë dhe lëkurën. Në raste të tilla lëkura të lahet me ujë të pastër, ndërsa për sytë duhet kërkuar ndihma e mjekut.

PAKETIMI:

Në thasë letre nga 25kg. që janë të mbrojtura nga lagështia.



DEPONIMI:

Të deponohet në hapësira të thata, mbi paleta të drurit. Afati i deponimit është 6 muaj.

Të dhëna teknike:	
Numri i prodhimit	5319990620323
Shifra e prodhimit:	1000 MI
Thasë në paletë:	42
Njësia sasiore:	40 kg/EH

RENOFIX DICHTUNGSCHEME

Granulacioni:	0 - 0,6 mm
Sasia e nevojshme e ujit:	4,5 - 6,5 l./thes
Trashësia minimale e shtresës:	1 - 2 mm
Harxhimi:	2 - 2,5 kg/m ² /2 mm
Shënim:	Vlerat e harxhimit janë aproksimative (të përafërta) dhe varen shumë nga bazamenti dhe teknika e ndërtimit.
Dendësia e materialit kur është i thatë (EN 1015-10):	ca. 1900 kg/m ³
Fortësia e ngjeshur (B3345):	ca. 1500 kg/m ³
Fortësia gjatë shtypjes pas 28 ditëve (EN 1015-11):	ca. 20 N/mm ²
MG (EN 998-1):	GP CSIV W1
MG (ON B3340):	PM4, W2

Udhëzime të përgjithshme:



Me këtë listë të gjitha të dhënat e mëparshme për materialin bëhen të pavlefshme. Këto të dhëna janë të vlefshme për testimet tona të tanishme. Nga këto të dhëna nuk mund të dalë detyrim juridik. Prodhimet RENOVA, si dhe të gjitha lëndët e para përbërëse janë gjithmonë nën kontroll të vazhdueshëm me qëllim të ruajtjes në vazhdimësi të cilësisë së njejtë. Konsulentët tanë teknik janë gjithmonë në dispozicion tuaj në lidhje me punën, përdorimin dhe prezantimin e prodhimeve tona. Gjendjen aktuale të të dhënave teknike mund ta gjeni në ueb faqen tonë: www.renova.com.mk si ose mund t'i kërkontë në sektorin e shitjes.



RENOVA PUTZ | www.renova.com.mk

RENOVA Xhepçisht, Tetovë, Maqedoni | Tel.: 044 487 300 | Fax: 044 487 200 | info@renova.com.mk
RENOVA Gureza, Ferizaj, Kosovë | Tel.: 00381 290 323 311 | Fax: 00381 290 396 396 | renova_ferizaj@hotmail.com
RENOVA Vore, Tiranë, Shqipëri | Tel.: 00355 48 301 909 | Faks: 00355 48 301 908 | renova.tirana@hotmail.com